



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:032723

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06311912

C.nr.129/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B. A., D. B., K. K. T., L. V., M. J., K. H., P.V., që të gjithë nga M., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Uvejs Gashi, avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arbnor Murturi, avokat me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensimi për shkallë të inflacionit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 17.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të pohimit)

- I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B. A., D. B., K. K. T., L. V., M. J., K. H., P.V., që të gjithë nga M. ashtu qe **DETYROHET** e paditura Komuna e Mitrovicës-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve, në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit, ti kompensoj si vijon:
- Paditësit B. A, në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për ... dhe ... (për ...muaj, periudhën janar-nëntor), shumën prej ... €;
 - Paditësit D. B, në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin 2021 dhe vitin 2022 (për 11 muaj, periudhën janar-nëntor), shumën prej ... €;
 - Paditësit K. K T., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin ... dhe vitin 2022 (për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumën prej ... €;
 - Paditësit ., L. V, në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për ... dhe vitin 2022 (për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumën prej ... €;
 - Paditësit M. J., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin ... (... muaj, periudhën janar-nëntor), shumën prej ... €;
 - Paditësit K. H., në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin ... (për ...1 muaj, periudhën janar-nëntor), shumën prej ... €;

- Paditësit P.V, në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit për vitin ...për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €;

II. DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve t’ia kompensoj detyrimin nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe kamatën në lartësi prej 8%, nga data e ushtrimit të padisë (datë ...) deri në pagesën e tërsishme, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej ... €, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Arsyetim

Paditësit, me datën ..., pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi, e të precizuar përmes parashtresës të datës ..., kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës, Drejtoria Komunale e Arsimit, me anë të së cilës kanë kërkuar që të obligohet e paditura t’i paguaj në emër të kompensimit për shkallë të inflacionit, për paditësin B.A. për periudhën kohore për vitin ... dhe vitin ... (për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €, për paditësin D. B. për periudhën kohore për vitin ... dhe vitin(për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €, për paditësin K. K. T. për periudhën kohore për vitin ... dhe vitin ... (për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €, për paditësin L. V. për periudhën kohore për vitin ... dhe vitin ...për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... € për paditësin Miranda Jolla për periudhën kohore për vitin ... dhe vitin ...për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €, për paditësin K.H. për periudhën kohore për vitin ... (për ...muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €, për paditësin P. V. për periudhën kohore për vitin ... dhe vitin ... (për ... muaj, periudhën janar-nëntor), shumë prej ... €të gjitha me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data ..., datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën) në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata me Aktvendimin C.nr..... të datës, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqes përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje, e paditura më parashtresën e datës, (përgjigjen në padi) e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit për shkallë të inflacionit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 148 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, lidhur me kompensimin për shkallë të inflacionit, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 148 paragrafit 1 të LPK, me të cilin përcaktohet se “*në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të*

cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)” vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 dhe nenit 453 paragrafi 1 dhe 2 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore. Gjykata ka marrë për bazë vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, kjo sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej ...euro dhe taksës gjyqësore shumë prej ... euro, përkatësisht shumë e përgjithshme ... euro.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.129/2023, datë 17.10.2024

Gjyqtari
Fuad Haliti

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi se të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.